



REVISTA ALBANËT NR.3

QERSHOR 2024



1-2 > “BROADWAY” NË ARTURBINA!
ALBANËT SOLLËN “13-TEEN”

3-4 > CIKLI I ULËT VË NË SKENË
PROJEKTET MË TË MIRA

5 > PROJEKTET, TRADITA QË
NXIT TË MENDUARIT

6 > FESTA E SHKRONJAVE.
LAMTUMIRË ABETARE!

7-11 > RUBRIKA:
NXËNËSIT INTERVISTOJNË

12-13 > MODULI I AFTËSIMIT PËR
JETËN, RISIA ALBANE

14-15 > BIBLOTEKA ALBANËT,
NJË FIDANISHTE IDESH

16 > NXËNËSIT SYGJEROJNË TITUJ
LIBRASH PËR LEXIM KËTË VERË

17 > KLARA SERJANI:
“UNË JETOJ NË DY BOTË”

18-20 > ALBANËT E PASIONUAR ME
MATRICAT E KUBIT RUBIK

21-22 > BACK STAGE-I ALBAN:
MJALTË & LIMON!

23-24 > RUBRIKA PROFIL,
ELIA FEJZAJ

“Broadway” në Arturbina! Albanët zgjodhën “13-teen” si shfaqjen e vitit për ciklin e lartë.

Dolën nga korniza e pritshmërive të prindërve, mësuesve e madje edhe nga pritshmëritë e vetes. Performuan si profesionistë në produksionin e vetëm në botë me aktorë 13-14 vjeçarë. Në muzikalini “13-teen” nxënësit albanë na treguan në një skenë të vërtetë, atë që ndodh me këtë gjeneratë në jetën e vërtetë.

Aq shumë e shijuan “aktorët” këtë shfaqje, sa nuk donin të iknin nga skena edhe pasi perdja u mbyll dhe duartrokitjet ishin të gjata, ndërsa spektatorët aq fort “u tronditën” nga mesazhet dhe loja e interpretimi i arrirë, sa nuk dinin të largoheshin nga salla dhe kështu palët e kuptuan dhe njohën më mirë njëra-tjetrën.

Edhe pse një shfaqje e Broadway-it, problematika dhe libreti alban, “fliste shqip” për 13 vjeçarët dhe sfidat e tyre të përditshme si bullizimi, xhelozia, dëshira për të pasur sa më shumë miq, për të qenë “V.I.P”, por edhe problemet në shkollë e familje dhe jo rrallë edhe përballimi i divorcit të prindërve nga fëmijët adolescentë.





Aktrimi dhe muzika i sollën këto problematika jo si origjinali amerikan, pasi regjizori Endri Çela, mësuesja e muzikës Suela Tukaj dhe drejtuesja e shkollës Albanët, Irena Mane, një panel artistik tresh, i kishte përshtatur skenat me realitetin e GEN-Z në Shqipëri, në Tiranë, për ta sjellë materialin më pranë jetës së adoleshentëve albanë.

Një shfaqje shumëdimensionale me mesazhe të forta. Aktrimi këndimi, kërcimi dhe performimi në instrumente muzikore, erdhën nga nxënës, që me dëshirë dhe jo audicion, u bënë pjesë e një "shfaqje teatri", që e kishte suksesin të garantuar.

"13-teen" një vepër ikonë, "mbylli perden" e aktiviteteve e projekteve artistike të një viti mësimor. Shumë komplimenta kastit dhe produksionit alban!



Familja albane e ciklit të ulët festoi me një best-off të projekteve më të mira të vitit mësimor.

Nxënësit e klasave nga e para deri tek e pesta, sollën në skenën e Teatrit Arturbina një megaspektakël gjithëpërfsirës. Çdo nxënës i ciklit të ulëtu u ngjit në skenë dhe performoi "produktin" e këtyre projekteve, por edhe aftësitë që ata marrin prej tyre, një ndër to edhe komunikimi dhe e folura në publik, një vlerë që erdhi në këtë shoë si një spektër ngjyrash në mesazhe e ndjesi.

E hapën shfaqjen tridhjetë e dy nxënësit e klasave të para në shkollën Albanët, që sollën për prindërit dhe mësuesit "Festën e shkronjave", një kolazh, që i dha lantumirën librit të Abetares.

Për zogjtë folën e kenduan nxënësit e klasave të dyta. Përveç një dramatizimi ata bashkë me mësueset gjithashtu ndërtuan shuuumë fole tek Ferma Albanët, ku vodosën kafazet për shtegëtarët.

Nxënësit e klasës së tretë, gjatë këtij viti na sollën një projekt nga më të bukurit: "Dedikuar nënës"! Një performancë me shumë mesazhe dhe emocione, që ndërthuri dedikimin, mirënjojen dhe urimin për mamat dhe gjyshet.



Me moton: "Të gjithë jemi inteligjentë", dy klasat e katërtë sollën po ashtu një spektër emocionesh. Ata na kujtuan se ne të gjithë jemi unikë, që do të thotë të vlefshëm!

Na kujtuan se secili nga ne është i papërsëritshëm në inteligjencë dhe aftësi, secili ka pikat e forta, që duhet të dimë t'i përdorim si prirje, talent dhe përparësi.

Spektaklin e mbyllën klasat e pesta, që e tundën sallën!

Sallën dhe shpirtin e tundën me këngët dhe vallet e traditave tona, veshjet popullore, ritet e zakonet tona të lashta, sa vetë bota! Ata sollën dasmën e çdo krahine shqiptare dhe me finesë ju kërkuan miqve të hidhnin "napolona" mbi "nusen e dhëndrin", e nëse nuk ju ndodheshin me vete napolona edhe paratë, pranoheshin!

Kështu u mbyll edhe kjo festë wauuu e familjes Albane!



Projektet. Tradita albane, që i nxit nxënësit të mendojnë vetë.

Janë ndoshta pjesa më e veçantë në shkollën Albanët. Projektet zhvillohen, jo vetëm si pjesë e programit, por edhe si synim parësor i shkollës për t'i bërë projektet një faktor me valencë të madhe në procesin e edukimit. Është kjo një tjetër traditë vjetore që mezi pritet nga nxënësit dhe mësuesit.

Projektet nuk zhvillohen vetëm brenda klasave si orë mësimore, por edhe jashtë shkollës, madje edhe jashtë Shqipërisë me intervista e biseda on line. Koordinatat gjeografike të projekteve zhvendosen nga klasat në institucionë, natyrë, sipërmarrje prodhimi apo me target grupe sipas tematikave.

Në shkollën Albanët projektet vijnë si prezantime para prindërve, mësuesve dhe nxënësve të klasave të tjera. Projektet e "fikin" butonin e mësimit për 1 javë dhe klasat kthehen në laboratorë idesh dhe iniciativash. Për një javë rresht mësimi bazohet mbi projektet, që ideohen nga nxënësit dhe mësuesit. Së pari vlerësohen gjetjet e temave inovatore, të cilat nxisin mendimin kritik, bashkëpunimin, komunikimin dhe kreativitetin. Pastaj grupet nëpër klasa vijojnë me zhvillimin e ideve dhe së fundi gjithçka finalizohet me prezantimin e projektit.

Kjo javë thellësisht albane, zhvillon tek nxënësit aftësi për të menduar vetë, për të punuar në ekip, aftësi për zgjidhjen e problemeve, aftësi të shkrimit dhe komunikimit.

Kjo metodologji mësimdhënie motivon tek nxënësit aftësi dhe potencial, që vetë nxënësit nuk mendojnë se i kanë. Ata motivohen, sepse ndjehen të përfshirë dhe të vlefshëm, ndërsa mësuesit "dalin nga kornizat" dhe kthehen në "kolegë".



Festa e shkronjave. Lamtumirë Abetare!



Gjithë jetën do merrni diploma, dëshmi e kualifikime të vlefshme, por kjo certifikatë me logon Albanët, e para në shkollimit tuaj, do jetë ajo që filloj për ju rrugëtimin drejt njohjes, përgjegjësisë dhe pavarsisë.

Tridhjetë e dy nxënës të dy klasave të para në shkollen Albanët i kanë dhënë lamtumirën librit të tyre të parë, Abetares.

Në këtë festë të shkronjave, ata të gjithë ishin si "një libër", ku tek secili "lexohej" çfarë dhe si ishte shkruar nga dy bashkëautorët: mësues-prindër.

Edhe pse dëshirat, prirjet dhe ambiciet tuaja do të ndryshojnë shumë herë gjatë rrugës, ju duhet të dini, se gjithmonë do ja dilni të jeni të suksesshëm, por ajo që nuk duhet të harroni është të përpileni për të qenë edhe të lumtur!

Mirënjoyje stafit mësimor për punën e palodhur dhe po aq prindërve për besimin dhe mbështetjen! Të gjithë bashkë ja dolët! You did it!

Sukses pafund nxënësve albanë!





Unë jam Aria Hazizi, nxënësë në klasën e dytë B. Kam kohë që kam kërkuar të jem pjesë e rubrikës "Nxënësit intervistojnë" dhe kur më thanë se do jem pjesë e këtij numri, e mendova mirë se kë doja të intervistoja. Anila e revistës më tha se duhet të zgjedh vetëm një njeri për ta intervistuar, por unë nuk isha fare dakort. Unë dua të intervistot tre veta, që punojnë tek shkolla Albanët dhe që i shoh çdo ditë. Unë vendosa të zgjedh dy mësuese, që i dua shumë. Edhe të tjerat i dua pooo...

E para është mësuesja ime, Linda dhe e dyta është mësuesja e anglishtes, Alba.

Por dua të intervistoj edhe mësuese-drejtoresh Irenën. Mendoj që ajo do bëjë edhe foto me mua, se unë do dal në revistë dhe tani jam e rëndësishme.

Po filloj me mësuese Lindën:

-Mësuese Linda ti je mësuese shumë e mirë. A të pëlqen që je mësuese? Pse e zgjodhe këtë profesion?

-Po Aria, unë e dua punën time si mësuese, sepse ndihem e lumtur pranë jush dhe kam kënaqësi të shoh, sesi rriteni çdo ditë në rrugën e dijes. Unë zgjodha këtë profesion, sepse gjithmonë kam dashur të ndihmoj dhe të edukoj fëmijët për të krijuar një ndryshim pozitiv në jetën e tyre.

-Mësuese Linda unë e di që ti më do, se e kuptoj. Ti i do të gjithë ata që ke nxënës? Apo vetëm disa?

-Ështe e vërtetë, ju dua shumë Aria, ashtu si edhe ju me falni gëzim dhe dashuri çdo ditë. Unë i dua të gjithë nxënësit e mi në mënyrë të barabartë.

Secili prej tyre është i veçantë dhe unik në mënyrën e tij. Për mua është e rëndësishme të jap vëmendje dhe mbështetje maksimale për të gjithë nxënësit, duke i inkurajuar ata për të arritur qëllimet e tyre dhe të shkëlqejnë në atë që ata bëjnë.

-Kur punoje tek shkolla tjetër si ishin nxënësit atje? Ndryshojnë nxënësit mësuese Linda?

-Tek shkolla tjetër fëmijët ishin shumë të mirë dhe unë i kujtoj me mall. Tani janë bërë prindër dhe prapë vijnë dhe më takojnë. Por ju keni një ndryshim nga ata, do thoja një meritë madje, që askush nga ju nuk e di. Më bëtë mësuese për herë të dytë, pas 15 vitesh emigrimi në Itali. Ju do të thoni: Po si të bëmë ne ty mësuese? Po, ju më bëtë mësuese, pasi një mësues nuk mund të kuptohet pa nxënësit e tij.

Për këtë unë ju dua pafund dhe ju jam shumë mirënjoyhëse ❤️

-Edhe ne të duam ty. Faleminderit mësuese Linda!



Tani do pyes mësuese Albën, që është tipe dhe e bën mësimin e anglishtes argëtues.

- Mësuese Alba unë të zgjodha, sepse më pëlqen shumë ti dhe ora e anglishtes, aq sa mezi e pres. Po ty tē ka pëlqyer ora e anglishtes, kur ishe nxënëse?
- Në shkollën "Skënder Çaçi", në Tiranë, në vitin 1998, u fut në kurrikulat shkolllore për herë të parë gjuha angleze. Unë isha vetem 10 vjeç dhe kontakti im me këtë gjuhë të huaj ndodhi pikërisht atëherë. Ajo orë e parë mësimi, që fillimi i një rrugëtimi, që vijon ende sot të përshkrohet me shumë dashuri.
- Sa gjuhë të huaja di ti mësuese Alba? Unë tē shoh shpesh me libra jo shqip në dorë, lexon libra jo shqip më shumë se shqip?
- Unë zoteroj tri gjuhë të huaja: anglisht, italisht, spanjisht. Të jesh njohës i një gjuhe të huaj të bën njohës tē një kulture tē re, ose si tē ta them unë ty Aria, ti njeh një një botë tē re. Është si një dritare, apo si një qilim fluturues, që nuk tē le të biesh kurrë, madje të shëtit nëpër mijëra vende tē mrekullueshme. Gjuhët e huaja janë pasioni im më i madh dhe ku ka me mirë, sesa këtë pasion të mund ta lidh me pasionin tim tjetër tē madh, që është ai i te lexuarit. Unë lexoj sa herë gjiej një moment tē lirë, kudo, pasi qetësinë dhe mrekullinë, që gjiej mes shfletimit të faqeve të një libri, nuk e gjiej askund tjetër.



-A ju ke mësuar fëmijëve tē tu anglisht, apo ata shohin Youtube dhe e mësojnë vetë anglishten?

-Kontakti me teknologjinë sot, duam apo s'duam ne, mbetet i pashmangshëm, por me pak kujdes tē shtuar, platforma tē ndryshme si Youtube, mund tē na sjellin përfitime tē shumta, ndër to edhe ajo e mësimit tē një gjuhe të huaja. Të dy fëmijët e mi, me një minutazh tē caktuar dëgjojnë/ shohin Youtube dhe unë përpinqem t'i orientoj drejt tē përdorurit sa me efektiv tē teknologjisë. Besoj edhe prindërit e tu kështu bëjnë me ty Aria.

-Po mësuese ju prindërit jeni njësoj. Faleminderit për intervistën!

Tani do pyes mësuese-drejtoresh Irenën:

-Unë të zgjodha ty se je drejtoreshë e mirë dhe e bukur. Është hera e parë që unë bëj një intervistë mësuese drejtoresh Irena. Je më shumë drejtoreshë apo mësuese, se nuk di si t'ju thërras?

-Jam e lumtur Aria që më quan drejtoreshë të mirë! Unë mundohem të jem mësuese e mirë për nxënësit e mi, por edhe të drejtoj me kujdes stafin e mësuesve të shkollës. Është punë e lodhshme dhe e vështirë, por edhe shumë e bukur! Sa herë nxënësit kanë suksese tek Albanët apo kur dalin në jetë, për mua dhe mësuesit është kënaqësi e madhe!

-Unë dua të bëhem drejtoreshë, po mami më thotë të bëhem arkitekte. Ka profesion drejtoreshë e arkitektëve? Është mirë të jesh drejtoreshë?

-Arkitekte është profesion shumë i bukur dhe drejtoreshë të arkitekteve ka. Mund t'i bësh të dyja. Por unë mendoj se ti do ta kuptosh më mirë se çfarë dëshiron të bëhesh pas disa viteve. Atëherë, duke dashur më të mirën tënde edhe prindërit do të mbështesin, se është shumë e rëndësishme të bësh punën që do. Nëse bën atë që e do, puna nuk të duket punë, por kënaqësi. Nëse ti mëson mirë, si tani, me siguri do të bëhesh drejtoreshë e profesionistëve të fushës, që do zgjedhësh.

-A mund ta kem edhe vitin tjetër mësuese Lindën dhe Albën si mësuese? Mendoj se drejtoreshat e vendosin këtë dhe unë dua t'i kem ato prapë mësuese.



-Për vitin që vjen Albanët do të bëjnë disa projekte shumë të bukura. Po e "zbuloj" në intervistën me ty Aria për herë të parë, që në ditën kombëtare, ne Albanët do bëjmë një koncert të madh përfestat e nëntorit, ndoshta më i madhi i realizuar deri tani. Dhe më pas edhe shumë projekte të tjera, që dojen surprizë. Dhe në të gjitha këto, ti dhe klasa jote do të keni kujdesin e mësuese Lindës. Edhe mësuese Alba do të jetë me ju, se ju do shumë. Ke të drejtë Aria që i do mësuese Lindën dhe Albën. Edhe unë i dua shumë, sepse si shumë mësues të tjerë tek Albanët, ato përpilen që nxënësit të vijnë me kënaqësi e të largohen nga shkolla të kënaqur.



Në këtë rubrikë, ku nxënësit albanë sjellin intervistat e tyre, të bëra me personazhe, që vetë ata zgjedhin, nxënësi Kres Kashta ka intervistuar idhullin e tij, d.m.th mamanë e tij. Shijojeni!

-E dashur mami dua që të bëjmë bashkë intervistën tonë të parë. Ndoshta do kemi edhe shumë intervista të tjera gjatë jetës sonë.

-Të duket çudi, që unë të të bëj një intervistë për revistën e shkollës sime?

- Po, vërtet! Është çudi dhe shumë kënaqësi njëkohësisht! Me vjen çudi, se sa shpejt u rrite dhe jam shumë e kenaqur, që ti je bërë një djalë kaq i mbarë dhe i sjellshëm (përveç se simpatik, që na bën mua dhe babin shumë krenarë.

-Pse zgjodhe për shkollimin tim një shkollë private dhe jo arsimin publik? Apo meqë kemi lek?

-Jo, zgjedhja jonë për shkollimin tuaj nuk ka fare lidhje me paratë. Vendimi jonë për shkollë publike, apo shkollë private, si fillim erdhi, sepse në shkollen publike mësimi mbaronte më herët se në shkollën private dhe unë e babi ishim në punë. Të ardhurat tona jane, aq sa të sigurojmë një jetesë normale me nevojat e përditshme të një familjeje, pra nuk mund të quhet që "kemi lekë".

- Tani e kuptoj përsë në shkollë private, por në Tiranë ka shumë të tilla. Mund ta di përsë bashkë me babin zgjodhët pikërisht shkollën Albanët?

Ne zgjodhëm shkollën "Albanët", sepse aty gjetëm një ambient shumë të mirë dhe mikpritës për një fëmijë, që do të fillonte klasën e pare. U ndjemë të sigurt, që ti po e filloje jetën tënde shkollore në një vend, që do të të mësonte jo vetëm dijen, por dhe vlerat që duhet të kesh në jetë.



-Mami! A mund të di cilat mendon ti, se janë pikat e fortë dhe përparësítë e shkollës sime? Ato gjera që ty tē bëjnë të mendosh se keni bërë zgjedhjen e duhur për mua!

-Ka shumë gjëra të cilat në këndvështrimin e prindit, i vlerësoj te shkolla Albanët, po nuk besoj se del vendi në faqet e revistës, që ti përmend tē gjitha. Sikurse e thashë më sipër, së pari shkolla Albanët na u duk shumë mikpritëse, ndërkohë pas kaq shumë vitesh bashkë, mund tē them me bindje, që është vendi i duhur për tē shkolluar fëmijët, pasi ofrojnë me tē njëtin përkushtim si mësimdhënien dhe përcjelljen e dijes, ashtu dhe dashurinë për artin dhe kulturën. Dhe ajo që unë vlerësoj më shumë nga tē gjitha është dashuria, fryma e mirësjelljes dhe respektit për njëri-tjetrin, që ju mësojnë dhe ofrojnë çdo ditë.



-Dakort e kuptova, përsë një prind zgjedh për shkollimin e tij Albanët. Por besoj, se shkolla ime ka edhe gjëra, që duhet tē jenë ndryshe dhe duhen përmirësuar. Cilat mendon se janë ato?

-Hmm... ndoshta së bashku me ne prindërit duhet tē përpiken t'ju bëjnë tē lexoni më shumë libra dhe tē shpenzoni më pak kohë me lojërat në kompjuter apo celularë. Kjo ndoshta mund tē arrihet duke dedikuar tē paktën një ditë në muaj, ku secili nga ju prezanton librin, që ka lexuar.

-Ke diçka, që nuk e thamë dhe do t'ja u përcjellim lexuesve të Revistës Albanët?

-Po Kres, mendoj që është shumë e rëndësishme tē them, që ti je bërë një djalë kaq i mbarë dhe i mirë, jo vetëm falë nesh, por edhe falë shkollës dhe mësuesve, që tē mbështesin. Uroj që shkolla Albanët tē vazhdojë tē rritet bashkë me ju dhe tē vazhdojë për shumë kohë udhëtimin e saj, pasi ka një mision shumë tē rëndësishem në përgatitjen e brezave tē rinj, si njerëz tē denjë, që mbartin dije dhe vlera dhe japin kontributin e tyre për një Shqipëri më tē mirë.

Moduli i aftësimit për jetën, një nismë albane për zhvillimin emocional dhe praktik të fëmijëve shqiptarë.

Në shkollën jopublike Albanët nxënësit pajisen sipas kurrikulës me njohuri e dije, por kjo nuk mjafton. Në shkollën shqiptare përfshihet pak ose aspak aspekti i aftësimit emocional të fëmijëve e të rinjve. Nëse i pyet, ata thonë se ndjehen jo të aftë të përballojnë vështirësitet e përshtatjes me jetën e realitetin jashtë, zgjidhjes së konflikteve etj.

Kjo nevojë e tyre ka bërë që në shkollën Albanët, të shtohet një moduli ekstrakurrikular, ku ata marrin edhe aftësi praktike, të domosdoshme për të përballuar "sfidat" e tyre, ato të përditshmërisë. Mësuesja e këtij moduli jolëndor, Mariza Mulo, thotë se kjo orë ka rëndësi dhe vlerë, po aq sa një orë e programit standart, vetëm se ajo pritet më me dëshirë nga nxënësit. Mulo thotë se ky vit i parë i testimit të kësaj nisme tek Albanët rezultoi më efikas, se sa pritej në shtator.

Mariza Mulo: "Pas hulumtimit dhe konsultimeve, u krijuar një kornizë fillestare për modulin e aftësimit për jetën. Në fakt është një risi në shkollën Albanët, për të cilën jemi frymëzuar nga modeli japonez i mësimdhënies, i njohur tashmë për qasjen gjithëpërfshirëse, ku bën pjesë edhe edukimi moral, puna në grup dhe pjesëmarrja aktive në komunitet".



Në vitin e parë të testimit të kësaj nisme tek Albanët, moduli i aftësimit për jetën rezultoi më efikas, se sa pritej në shtator. Ai jo vetëm do të vazhdoj në vitin e ri mësimor, por do të jetë edhe më i komplektuar dhe gjithëpërfshirës.

Ky modul ofron mësimë praktike dhe interaktive duke përfshirë një gamë të gjerë temash si aftësi komunikimi, menaxhimi i kohës, aftësi sociale, financiare, por edhe aftësi praktike si gatimi, mirëmbatja e shtëpisë, klasës, zhvillimi i empatisë, etj.

Moduli i aftësimit për jetën zhvillohet nga klasa e parë deri në klasën e gjashtë.

Mësuese Mariza thotë se jo vetëm shkolla, por edhe prindërit duhet ta bëjnë këtë përpjekje që fëmijët të jenë të aftë e të përgjegjshëm për të qenë të pavarur në jetën e tyre të përditshme. "Kjo përpjekje nuk duhet të bëhet vetëm nga shkolla dhe të mbetet këtu. Duhet të ndiqet i njëjtë trend edhe nga prindërit dhe familjarët e tjerë të nxënësve, anëtarë të komunitetit etj. Ne të gjithë së bashku duhet të synojnë të njëjtën qasje edukimi për brezin e ri, që kjo mënyrë edukimi të jetë efikase".



“E kam imagjinuar gjithnjë Parajsën si një lloj biblioteke.”

Jorge Luis Borges

Një libër mund të ndryshojë mënyrën se si e shohim jetën, madje mund të të ndryshojë edhe vetë jetën. Një kënd që mund të ndryshojë për mirë jo një, por shumë jetë, është edhe Biblioteka Albanët.

Si në çdo biblotekë këtu, tek kjo klasë e vogël, enden fantazi e ide, formësohen koncepte, e ëndërra përveten, shoqërinë, botën dhe universin.





Nuk është një bibliotekë e madhe, nga ato me shkallë e rafte me kate, ku mund të gjesh çdo titull e autor, por është një "parcelë", ku zhvillohet mendimi, krijohet opozitari dhe krijuesi i së nesërmes.

Këtë vit ne e kemi pasuruar bibliotekën me blerje të titujve të rinj, por edhe prindërët e komunitetit alban na kanë përkrahur dhe dhuruar shumë libra e po ashtu edhe mësuesit duke e bërë funksionimin e bibliotekës edhe më efikas dhe interesant për nxënësit alban.



Në Bibliotekën Albanët ka një pavion të librave edhe në gjuhën e huaj (anglisht, italisht), por sidomos spikat seksioni i titujve në gjuhën frëngë, dhurim i Ambasadës Franceze, falë binjakëzimit dhe bashkëpunimit me të inicuar nga drejtuesja e katedrës së gjuhëve të huaja, Borana Noshi. Mbetet shumë për tu bërë në pasurimin me tituj dhe autorë të rinj e sidomos me libra shkencorë e didaktikë për stafin mësimdhënës, një objektiv ky, për vitin e ardhshëm mësimor

Lexuesit më të mirë të Biblotekës Albanët sygjerojnë tituj që mund të lexoni këtë verë!

Nëse doni të lexoni një libër, duhet të gjeni të duhurin. Për të gjithë nxënësit albanë dhe jo vetëm, disa nga lexuesit më të mirë të ciklit të ulët në Biblotekën Albanët, vijnë me këto tituj si sygjerime për lexim!



Ilion Hasanaj është nxënës i klasës së parë. Ai sygjeron të lexoni librin "Në vendin e njëqind mijë dëshirave" me autor Andre Morua.

Ndërsa Aria Hazizi dhe Rejna Tafa të dyja janë shoqe klase, nxënësë në klasën e dytë. Çuditërisht të dyja kanë lexuar 9 libra secila për këtë vit dhe sygjerojnë titujt më interesantë, sipas tyre. Aria sygjeron antologjinë "Sekreti i Ëndrrave", ndërsa Rejna librin e Andersenit, "Princesha mbi Bizele".

Nxënësja e klasës së tretë Ana Biba thotë se ka lexuar 10 libra këtë vit dhe sygjeron të lexoni "Princin e vogël" të autorit Antoine De Saint-Exupery.

Janë në klasën e katërt, Nian Leka dhe Ebi Kasmi. Besojeni ose jo, por edhe në këtë rast mësuesja nuk e ndante dot, cili ishte emri i lexuesit më të mirë, sepse të dy kanë lexuar nga 9 libra. Niani sygjeron të lexoni "Kapiten Brekushin" e Dav Pikley, ndërsa Ebi ju nxit "të udhëtoni" "Reth botës për 80 ditë", Zhyll Vern.

I fundit me sygjerimin e librit të tij vjen Egi Erzeni, nxënës i klasës së pestë. Me 12 libra të lexuar në bibliotekë, ai sygjeron "Djemtë e rrugës Pal" Ferenc Molnar.



Lexuesit më të mirë në Biblotekën Albanët sipas klasave.

Klasa e parë A

Emma Vata
Analdo Toska
Elif Sejko
Ester Feshti
Matias Troka

Klasa e parë B

Egin Serani
Ilion Hasanaj
Noel Shllaku
Amlı Priam Bitri
Amar Xhixha

Klasa e pestë B

Keira Daneski
Jora Hushi
Henki Duraj
Inva Demaj
Endi Hysa

Klasa e tretë

Ernest Demolli
Kristel Ristani
Gloria Qirjo
Emma Xhafa
Sofi Karralliu
Bjorn Hoxha

Klasa e dytë A

Erlin Seriani
Kostandin Pesha
Martin Bega
Riduan Matica
Roan Zhllima
Anajd Allmeta
Ania Kruja

Klasa e katërt A

Elia Feimi
Tea Kashta
Alvio Zhekulli
Jason Dhimitriadihi
Amar Abdyli

Klasa e katërt B

Nian Leka
Andrea Gecaj
Ebi Kasmi
Luis Lala

Klasa e dytë B

Julien Kadria
Rejna Tafa
Ajan Muça
Gedion Basko
Enian Prenga

Klasa e pestë A

Ema Bleta
Egi Erzeni
Ania Dizdari
Tedi Raveli



Klara Serjani: “Unë jetoj në dy botë”

Unë jetoj në dy botë. Njëra është bota e librave, një vend ku unë bëj udhëtime të mahnitshme nëpër kohë dhe hapësirë, duke përjetuar aventura të mrekullueshme dhe duke njojur personazhe të ndryshëm. Në këtë botë, unë kam gjuarjtur balenë e bardhë në bordin e varkës Pekuod, kam luftuar së bashku me Napoleonin në fushëbetejë, kam lundruar në një gomone me Hakun dhe Xhimin në detin Egje, kam hipur në një tren të trishtuar me Anna Kareninën nëpër stacionet e Rusisë dhe kam shëtitur rrugën Suan. Kjo botë e librave është një botë e mrekullueshme, e pasur me eksperientat më të mahnitshme dhe leksionet më të rëndësishme për botën dhe jetën. Qysh në fëmijëri, miqtë e mi më të mirë kanë qenë librat. Ata kanë qenë udhëzuesi im i përhershëm, shokët e mi më të besueshëm në momentet e gjëzimit dhe trishtimit. Familja ime ka pasur një ndikim të jashtëzakonshëm në këtë pasion për timin. Ata më kanë inkurajuar të mos heq dorë nga leximi, të mos ndalem në kërkimin për njojuritë dhe frymëzimin, që librat ofrojnë. Ndërsa tjetra, shoh me zhgënjim moshatarët e mi që zgjedhin të investojnë kohën e tyre në rrjete sociale dhe internet, duke e humbur kështu mundësinë për të kultivuar mendjen dhe shpirtin e tyre me lexim.



E vërteta është, se unë vetë ndonjëherë, fare pa e kuptuar bëhem viktimi e internetit dhe portaleve, por pastaj reflektoj e sërisht futem në botën e librave, ku gjej gjithçka. Megjithatë, vlera e librave në ditët tona duket se është në pikiatë.. Në kohën kur teknologjia dhe interneti mbizotërojnë, shumë njerëz kanë harruar vlerën thelbësore të leximit dhe mënyrën sesi ato mund të transformojnë jetën tonë për mirë. Dhe ndonëse e pranoj, që koha dhe shoqëria janë në ndryshim të përhershëm, unë mbeten e bindur se librat duhet të mbeten një nga themelët e jetës së njeriut modern.


Librat janë më shumë se thjesht faqe të mbushura me fjalë; ata janë portat, që na hapen drejt mendimit, reflektimit, dijes, humanizmit, imagjinatës. Të njoftohësh dikë nga librat që ata lexojnë është të kuptosh shpirtin e tij, të eksplorosh mendjen dhe zemrën në mënyrë unike, mundësi që nuk janë të mundshme nëpërmjet asnjë rrjeti e media sociale.

Prandaj, unë inkurajoj çdo moshatar, që të përkushtohet në lexim. Nuk kushton shumë të gjejë kohë për një libër, ndërkojë që ajo që merr në këmbim, nuk ka të çmuar. Bota jonë do të ishte shumë më e pasur dhe më e qetë, nëse secili prej nesh do të kishte praktikën e leximit të një kapitulli më shumë në ditë.


Albanët e pasionuar me matricat e Kubit Rubik Enigma e ngjyrave me 43 trillionë pozicione të mundshme.

Disa e zgjidhin me sy mbyllur, të tjerëve u dhemb koka vetëm duke e parë. Për çfarë po flasim? Për pazëllin më të famshëm në botë, Kubin e Rubikut.

Nuk kemi bërë ndonjë anketim, se sa e pëlqyer është kjo enigmë algoritmesh mes nxënësve albanë, por e sigurt është, që në shkollën tonë ka qasje për rekorde kombëtare e madje ambicje drejt atyre ndërkombëtare, përsa i përket kohës së zgjidhjes së kësaj "lodre të mençur", për të cilën, sipas matematicienëve, lëvizjet duhet të mendohen gati 20 hapa para.



Ja tre supernxënës, që spikasin përvèç se me ekselencën e notave edhe me aftësinë dhe metodologjinë në zgjidhjen e Kubit Rubik.



Matiasi Hasanaj është nxënës në klasën e gjashtë, por në shkollën albanët ai studion matematikën e klasës së tetë dhe zgjidh ushtrime olimpiadash ndërkombëtare si RSM (Rusian Sience Math). Në olimpiadën ndërkombëtare Kangaroo Math 2024, që afersisht zhvillohet në 100 shtete, Matias zuri vendin e parë në Shqipëri. Matiasi aktualisht e zgjidh Kubit Rubik për 10 sekonda dhe tashmë ka një profil të tijin në WCA (World Cup Association), qysh nga viti 2022, kohë kur për Rubikun i duheshin 30 sekonda.

Matias ka mbi tre vjet që praktikon metodat dhe kombinacionet më efikase dhe di përmendësh algoritmet, madje ka algoritme, që janë edhe kombinim i dy algoritmeve. Ai na thotë se zgjidhjen e Kubit e nis me faqen e verdhë për të cilën përdor një kombinim me 57 algoritme, ndërsa për hapin e fundit, thotë se ai përdor 21 algoritme.



Matiasi aktualisht e zgjidh Kubin Rubik për 10 sekonda dhe tashmë ka një profil të tjin në WCA (World Cup Association), qysh nga viti 2022, kohë kur për Rubikun i duheshin 30 sekonda. Matias ka mbi tre vjet që praktikon metodat dhe kombinacionet më efikase dhe di përmendësh algoritmet, madje ka algoritme, që janë edhe kombinim i dy algoritmeve. Ai na thotë se zgjidhjen e Kubit e nis me faqen e verdhë për të cilën përdor një kombinim me 57 algoritme, ndërsa për hapin e fundit, thotë se ai përdor 21 algoritme.




Po kështu edhe vëllai i tij, Ilioni, nxënës në klasën e parë po tek albanët duket se ka ndjekur të njëjtin pasion. Ai gjithashtu si edhe vëllai i tij ndjek video në You Tube se si mund të përmirësohet.

Kur hip në autobusin e shkollës për tu kthyer në shtëpi, Ilioni mezi pret të marrë në dorë Kubin dhe të ushtrohet, praktikë që duket se e ndjek kudo, sapo i jepet mundësia.

Vëllezër është Hasanaj thonë se ju pëlqen të ndërtojnë edhe lego. Të dy prindërit, mami Iris, dhe babi Shkëlzen, i përkasin fushës së teknologjisë dhe i nxisin të dy çunat për të zvilluara lojëra inteligjente e kreative.

KURIOZITETE

Kur i referohemi Kubit të Rubikut, flasim për një Kub me 6 anë dhe matricë 3x3x3. Por ka edhe kuba të tjera që ndryshojnë nga Rubiku original, si 2x2x2, 4x4x4, 5x5x5 madje edhe me forma jo kuboide, që kanë të njëjtin emër, por me algoritme shumë specifike, të veçanta për secilin model.



Po ju njohim edhe me Alvio Zhegut, një tjetër të pasionuar pas matricës 3X3X3. Ai është në klasën e katërt A dhe thotë se do bëhet matematicien ose shkencëtar. Për herë të parë kubin Rubik e pa në duart e babait të tij, Altinit, i cili pas jo pak përpjekjesh për ta zgjidhur, një mbrëmje, përfshiu edhe Alvion. Plotësuan vetëm dy faqe. Më pas babai u nxeh dhe i tha atij të shkonte të flinte, sepse orari i gjumit i kishte kaluar, duke i premtuar se kur ai të zgjohej do e gjente Kubin të zgjidhur.

Në mëngjes Alvio, pa vetëm një anë të zgjidhur. Ai e mori Kubin në dorë dhe i leu faqet me bojë, që të dukeshin të plotësuara.

Por edhe pse Alvio e bëri këtë truk, e kuptoi që nuk mund të gënjeni veten, ndaj i kërkoi ndihmë mamit.

Mami i Alvios, i gjeti një aplikacion në AppStore dhe më pas ai pa shumë tutoriale në You Tube duke ndjekur një instruktor amerikan shumë të njohur, J Perm, të cilin e pa vetëm një herë dhe ja doli t'i plotësojë të gjitha faqet, gjithmonë e me më pak lëvizje, gjithmonë e më shpejt, duke arritur në 12 sekonda.

Alvio ka memorizuar nga videot e Y-T kombinime komplekse, si ai i quajtur CFOP, por ndërkaq ai krijon edhe vetë "strategji" e metoda, që shkurtojnë hapat e zgjidhjes, të cilat mund edhe t'i tregojë në të ardhmen në kanalin e tij. Kur unë e pyes nëse i ka shkuar në mendje t'i vendosë edhe ai një emer metodës së tij më efikase, ai ma pëershruan atë me detaje, gjërë e gjatë, gati 15 minuta, por më tha se ende nuk i ka vendosur një emer, sepse përton. (Pff!)

Ju njohëm vetëm me tre nga nxënësit tanë, ata më të spikaturit në këtë lojë logjike, por është e pamundur që ndonjë prej jush të mos jetë përpjekur të zgjidhë këtë kub ikonë. Ndoshta edhe ky shkrim mund t'ju nxise këtë pasion, edhe pse nuk do mungojnë disa mama, që do ta quajnë këtë gjëgjëzë gjashtë ngjyrëshe "një humbje kohe".



KURIOZITETE

U krijua në 1974 nga Erno Rubik, një profesor hungarez i arkitekturës.

U licencua në 1980 nga Ideal Toy Company.

Janë shitur rreth 350 milionë të tillë.

21-vjeçari Max Park është kampioni botëror për formimin e Kubit Rubik, me 3.13 sekonda.

Vetë Rubikut ju desh një muaj për të zgjidhur për herë të parë.

-Dy inxhinierë softuerikë Jay Flatland dhe Paul Rose kanë ndërtuar një makineri, që e zgjidh gjëgjëzën e këtij kubi në pothuajse vetëm 1 sekondë.



BACK STAGE-I ALBAN: MJALTË & LIMON!

Eshtë ajo pjesë e stafit, që asnjëherë ose rrallë duket në takimet rutinë me prindërit, publikimet online, apo qasjet e institucionit drejt PR, por pa atë pjesë, nuk ka shkollë cilësore, sepse ushqimi i ofruar në shkollë eshtë një nga standartet, që ne kemi marrë përsipër të ofrojmë për mirëqenien dhe shëndetin e fëmijëve.

Po i referohemi stafit të kuziniereve e ndihmëskuzhiniereve të shkollës Albanët.

Janë këto zonja të mira e të palodhura, që bashkë me pjatat me ushqime, çdo ditë ju jasin nxënësve tanë kaq shumë dashuri.

Teta Bukri, një profesioniste me shuumë vite dedikim tek albanët eshtë në krye të kësaj superskuadre, që gjithë betejat e ditës e mbyll me urimin: "Ju bëftë mirë!"

Teta Mira, e mirë siç ka emrin, e duruara teta Elida, e palodhura teta Erjeta, kërkuesja teta Kristina dhe syblerta Rominë e nisin ditën me të njëjtin prioritet, punë cilësore në grup për garantuar tre vakte të freskëta e të shëndetshme për nxënësit albanë





Recetat e preferuara të albanëve:

Supë krem pule me bukë të thekur.
Tartë me spinaq e djathë.
Makarona me pana e proshutë.
Kek me çokollatë.

Ja dhe recetat më pak të preferuara:

Supë brokoli.
Perime të zgarës.
Sallatë.



Në shkollën Albanët ushqimi nuk merret i gatshme apo gjysëm i gatshëm nga jashtë për të përfunduar pastaj në tryizioni e fëmijëve, pas heqjes nga paketimi. Nuk porositet diku me catering, sepse ne i besojmë më shumë se askujt, vetes. Këtu çdo gjë gatuhet e përgatitet nga stafi ynë, siç bëjnë nënët dhe gjyshet e fëmijëve në shtëpitë tona. Shumë prej produkteve bujqësore e blegtoriale të përdorura në kuzhinën tonë janë ushqime organike të Fermës Albanët, për të cilat shpesh kujdesen edhe nxënësit tanë. Tek ne nuk ekzistojnë makinat shitëse, që ofrojnë pije me gaz dhe sheqer ose ushqime të paketuara.

Familja dhe me raste edhe shkolla, janë modeli se si i formësojmë fëmijët me edukatën e ushqimit në teori, por në fund të fundit, çfarëdo që tu themi, fëmijët tanë do të ndjekin në më të shumtën e rasteve zakonet tona, do përvetësojnë mënyrën dhe filozofinë me të cilën ne ushqehemi çdo vakt, ndaj ja vlen t'ju përcjellim atyre shëmbullin e mire e të shëndetshëm!



Rubrika Profil

Elia Fejzaj, talenti alban që e do këngën, sa gjyshe Dritën!

Ka emrin e një profeti, por profecia më e madhe për të është se ai do bëhet një këngëtar i famshëm. Elia Fejzaj është nxënës në klasën e katërt A dhe ka zbuluar se ka faktorin X në këngë. Ai ka marrë pjesë së fundi, për herë të dytë në Festivalin Kombëtar të Fëmijëve, që e pati finalen e tij këtë 1 Qershor, si gjithmonë në qytetin e Shkodrës.



Ka deputuar në Festivalin Kombëtar të Fëmijëve si solist me këngën "Tigri dhe gomari" të kompozitorit Jetmir Mehmedaj e teksti të mësuese Suelës, e cila e spikati zërin e tij në një orë muzike në shkollën Albanët. "Unë as nuk e dija që kisha zë e talent, thotë Elia, por pasi më zbuloi zysh Suela, unë tani e di, që jam special."

Familja e përkrah shumë Elian, por më e lumtur, ai thotë se është gjyshe Drita Qetollari. "Ajo më do mua më shumë nga të gjithë, dhe për Zotin nuk e di përsë, por amë e di që e dua atë sa këngën dhe muzikën!"



Elia ka vizion të qartë, pa dilemma. Ai e di se pas shkollës Albanët, do ndjekë liceun e pastaj Akademinë e Arteve e mandej do jetë këngëtar në skena e ngjarje artistike të mëdha. Do jetë i lumtur. Kaq!

I pëlqen matematika dhe futbolli, por muzika mban gjithmonë vendin e parë, kur vjen fjala për preferencat e zgjedhje.

Elia ka edhe këngëtarë që i pëlqen e dëgjon më shumë, por të gjithë ata që më listoi janë djem. Nga këngëtarët shqiptarë pëlqen Noizin, Alban Skënderajn dhe Igli Dodën. Ndërsa vokalisti më i preferuar i tij është këngëtar i italian, me origjinë egjiptiane, Mahmood, fitues në Sanremo 2019, këngët e të cilit shkojnë mbi 210M views.

Ky ishte vetëm profili i parë i Elias, të tjetër do vazhdojnë të shkruhen në revista e gjuhë të tjera. Suksese Elia!



Aktivitete të Qeverisë së Shkollës Albanët!

Aktivitet bamirësie në bashkëpunim me Fondacionin "Fundjavë Ndryshe".

-Çfarë është bamirësia?

-Një kujtim dhe një vend në zemrën e dikujt.

Sigurisht që nuk mund t'i ndihmojmë të gjithë, ama mund të ndihmojmë dikë!

Qeveria e nxënësve të shkollës Albanët ka organizuar një aktivitet bamirësie në bashkëpunim me Fondacionin "Fundjavë Ndryshe".

Ndihmat me produkte ushqimore, veshje, lodra e libra janë mundësuar nga familjet e nxënësve të shkollës sonë për familjet dhe fëmijët në nevojë. Më shumë se sa dhamë, morëm! Faleminderit prindër e mësues që mbështetët nismën tonë!



Qeveria e Shkollës Albanët organizoi edhe Panairin e Biznesit.

Me gotat plastike të mbushura me monedha e kartmonedha ditët e biznesit duket se shkuan mirë e madje shumë mbarë për nxënësit albanë, që të inicuar nga Qeveria e Shkollës organizuan Panairin e Biznesit.

Stendat e panairit, sipas klasave, ishin mbushur me ushqime dhe pije të përgatitura nga vetë nxënësit dhe padyshim edhe nga prindërit e familjarë të tyre.

Nuk ishte thjesht një tregëtim produkteve. Aspak! Çdo klasë ishte përpjekur shumë të sillte produktet e saj në mënyrë tërheqëse duke treguar kujdes në formën e produkteve dhe paketimin e tyre, por edhe drejt një qasje sa më afër koncepteve më efikase në marketing dhe shitje.

Kjo prirje ka qenë mjaft e lexueshme, madje disa nxënës kishin konceptuar logon e tyre dhe praktikuan "lojën" me çmimet përmaksimizimin e të ardhurave.

Përveç ushqimeve në panair ishin përfshirë edhe lojërat me qëllimin final, fitimin. Muzika dhe kërcimi mbylli gjëzueshëm atmosferën e të dy ditëve të këtij panairi, që i ngjasoi shumë një festë të hareshme. Thuhet nëpër "korridoret" e Qeverisë, se me paratë e fituara klasat do organizojnë ekskursione.



Kampionati Alban i Shahut.

Për një muaj rrjesht në të gjitha klasat nga e 1-9 Qeveria e Shkollës Albanët ka zhvilluar Kampionatin e Shahut përmes këtë vit shkollor. Aktiviteti ishte jo vetëm gjithëpërfshirës, por edhe i fortë, pasi në shkollën tonë organizohet mësimi i shahut si një orë jashtëkurrikulare nga instruktori Maksim Dervishi.





**PUSHIME TË BUKURA PËR TË GJITHË ALBANËT
NGA REDAKSIA E REVISTËS DHE KRYEREDAKTORIA ANILA RUÇO!**



REVISTA NR.3



QERSHOR 2024